



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë, 11.10.2012  
Nr. 0204-1066

**PËR: Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut**  
**Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut,**

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT NR. 16-24600/12 të pranuar më datën 27.09.2012**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 16-24600/12 të miratuar me datë 27/09/2012 nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut,, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendim Për Prolongim të Propozim-Vendimit,që ka të bëjë më: Formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave dhe për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Me respekt,

  
Slobodan Petrović,  
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së  
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave  
Arkivit të MAPL-së



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Dana, 09.10.2012  
Br. 0204-1066

**Za:** g. Besim Ilazi, Gradonačelnik Opštine Kačanik  
g. Xhelal Gashin, Predsedavajući Skupštine Opštine Kačanik,

**PREDMET:** POTVRDA zakonitosti Oduke Opštine Kačanik 01BR.16-24600/12

Primljeno dana 04.10.2012


Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za Lokalnu samoupravu Nr.03/L-040 , dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kancelarije Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke 01Br.16-24600/12 usvojene dana 27/09/2012 od Skupštine Opštine Kačanik, **POTVRDJUJE** zakonitost akta i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt koji proizvodi puni pravni efekat :

- Odluka 01Br.16-24600/12, za odlaganje Predloga-odluke, a koja se radi o : Formiranju komisije za procenjivanje ponuda i za davanje na korišćenje opštinske imovine .

S poštovanjem,

  
Slobodan Petrović,  
Zamenik Premijera i Ministar MALS-a,

**Kopija:** Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a  
Direktorima uprava i kancelarija  
Arhivu MALS-a



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik  
-Kuvendi i Komunës-  
01Nr. 16-24600/12  
Kaçanik: 27.09.2012

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në bazë të nenit 38 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 27.09.2012, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR PROLONGIM TË PROPOZIM -VENDIMIT 01Nr. 16-24600/12**

**I.**

Prolongohet Propozim-Vendimi i kryetarit të komunës, më numër protokoli: 01Nr. 16-24600/2012 i datës: 18.09.2012 që ka të bëjë më: Formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave dhe për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

**II.**

Kjo çështje do të vihet në shqyrtim në kuvendin e komunës, më propozimin e drejtorisë-respektivisht kryetarit të komunës, pasi të kryhen procedurat paraprake, kur një pronë e paluajtshme e komunës me vendim të kuvendit të komunës shpallet publikisht për t'u dhënë në shfrytëzim të përkohshëm, atëherë do të merren edhe hapat e mëtejshëm, për formimin e komisionit për vlerësim të ofertave dhe për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

**III.**

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit,  
z. Xhelal Gashi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Kaçaniku  
Komuna Kaçanik  
Skupština Opština  
Municipal Assembly

01-Nr. <sup>16-2460</sup> 2012  
Kaçanik, 18.09.2012

Në bazë të nenit 13 të ligjit për vetëqeverisje locale Ligji Nr.03/L-040, nenit 77 të ligjit për procedurën administrative Ligji Nr.02-L-28, nenit 34.5 të statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari I Komunës me date \_\_\_\_\_ 2012 merrë këtë:

### AKTVENDIM

MBI FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE DHE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE

#### I

Me këtë aktvendim formohet Komisioni Komunal në përbërje të përfaqësuesve të ekzekutivit të Komunës prej 3 anëtarëve dhe Kuvendit të Komunës prej 4 anëtarëve të komisionit :

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_
6. \_\_\_\_\_
7. \_\_\_\_\_

#### II

Komisioni ka për detyrë që të shqyrtoj dhe vlersoj ofertat dhe i propozon Kuvendit listën e ngushtë prej së paku 3 pretendentëve kryesorë për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike Komunale.

#### III

Me këtë aktvendim duhet të njoftohen : Kryetari, anëtarët e Komisionit DKUMM, dhe arkivi I Komunës.

Kryetari  
Z. Besim Hazi